



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-7352/20 datë:12.05.2020



Npi – 01/93 datë: 13.05.2020

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.7 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve 01Nr.06/2005-43, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 13.05.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 13.05.2020 (e mërkurë) në ora 14.00 h. në sallën e Kuvendit Nr.01

Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: z.Rrahman Kadrija, znj.Fatmire Ferati, z.Muhamed Ademaj, znj.Diarta Vishesella, znj.Xhevahire Ramadani, dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri; Zyrtari për Informim z.Gazmend Ademaj; Praktikanti, z.Egzonit Jakupi; Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Rrahman Kadrija, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26.02.2020,
2. Informatë nga ZKKK-ja dhe Kryesuesi i KPK për pandeminë KOVID19, në komunën e Shtimes me theks të veçante për komunitetin Ashkali dhe Rom,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26.02.2020,

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi ekstrakt procesverbalin nga mbledhja e kaluar e mbajtur më 26.02.2020.**

Pika 2

Informatë nga ZKKK-ja dhe Kryesuesi i KPK për pandeminë KOVID19, në komunën e Shtimes me theks të vegantë të komunitetit Ashkali dhe Rom

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Prezantoi një raport të shkurtër për sa i përket gjendjes së përgjithshme për sa i përket Pandemisë KOVID19, me theks të vegant te komuniteti Ashkali dhe Rom. Ne e kemi përgatitur informatën në formë të shkruar dhe ua kemi dërguar, por në vazhdim Kryesuesi z.Rrahman Kadrija e lexoi informatën, (shih dokumentin).

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Përshëndetje, ne po e paraqesim një informqatë për këta dy mauajt të cilët u karakterizuan me Pandeminë KOVID19. Është fat i mirë që nuk ka pas asnjë rast të infektuar me korona virusin nga komuniteti Ashkali e Rom, pavarësisht gjendjes së tyre të vështirë socio-ekonomike. Ne e kemi përgatitur informatën në formë të shkruar dhe ua kemi dërguar me kohë, unë po besoj se e keni lexuar dhe nuk kam nevojë unë tani ta lexoj, por i mirpres pyetjet dhe komentet e juaja, (shih dokumentin).

z.Arton Demiri; Përshëndetje, unë vetëm desha me e falënderuar ZKKK-në si dhe Organizatat tjera Joqeveritare që kanë sjellë donacione, qoftë në formë të pakove ushqimore ose higjenike.

znj.Fatmire Ferati; Përshëndetje, unë desha ta bëj një pyetje që ka të bëj me arsimin, se a kanë pas mundësi fëmijët e komunitetit pakicë me e përcjellë mësimin nga distanca? Unë deri tani nuk kam pas ndonjë informacion se sa ata kanë qenë në gjendje me e përcjellë mësimin, qoftë për shkak të paisjeve qoftë për shkak të rrjetit të internetit.

z.Muhamed Ademaj; Përshëndetje, e falënderojmë Ibrahimin për Informatën. E di që Shteti po e menagjon mirë situatën e krijuar me Pandeminë KOVID19. Është mirë që nuk ka pas të prekur nga korona virusi nga komuniteti pakicë. Është mirë për me menduar që me ju ndihmuar që edhe ata me kaluar vitin shkollor, dmth me i përcjellë mësimet. Po ashtu është mirë që nuk ka mbetur askush pa ndihma.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Pyetje me vend për sa i përket përcjelljes së mësimit. Sa e di unë është mungesë me paisjet elektronike, me televizor po por jo edhe me rrjet interneti ku do të mund ti bënin detyrat.

z.Muhamed Ademaj; Sa i kam pa unë në shkollë nuk ka nxënës që nuk ka telefon të menqur, kështu që është mirë për me i aktivizuar dhe me u kyqë në mësime.

znj.Fatmire Ferati; Aksioni i Shtetit për organizimin e procesit mësimor nga distanca është i mirë sepse edhe nuk ka mundësi tjetër në këtë kohë të Pandemisë. E di që ka sfida dhe probleme, por unë mendoj se duhet me e pas një listë të atyre nxënësve që nuk kanë qasje, sepse problemi është i detyrave, pastaj edhe ata që kanë më shumë fëmijë në shkollë e kan edhe më të vështirë, dhe ne e kemi pa se nuk është një numër i vogël. Mësimi On-line nuk mund të funksionojë në mënyrën më të mirë ashtu si ne po e proklamojmë, por duhet të bëjmë përpjekje që të përfshihen të gjithë nxënësit. Unë po shpresoj se qendra për mësimnxënje Shtime-Gjyrkovic-Vojnovc kanë bërë diqka në këtë drejtim. Ne duhet që sa më shumë ti informojmë prindërit e nxënësve, për tu angazhuar me qëllim që ta përfundojmë këtë vit shkollor ashtu si është më së miri, sepse nuk është e lehtë.

znj.Diarta Vishesella; Përshëndetje, kërkesave të fundit ne u kemi përgjigjur. Ndoshta edhe nuk po mundemi me bërë edhe aq shumë punë sepse ne jemi duke punuar jo vetëm për Shtimen, dhe krejt kjo punë që po bëhet është vullnetare. Si do që të jetë unë jam në dispozicion për të ndihmuar ju numrin tim e keni.

znj.Fatmire Ferati; Nuk është numër i vogël prej 122 nxënësve të ciklit të ulët, dhe cikli i lartë me 32 nxënës. Është shumë e qartë se për me e përcjellë mësimin si duhet ka problem edhe te nxënësit e komunitetit shumicë.

Pika 3 Të ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Unë po kërkoj që të vazhdojë ende bashkëpunimi, sepse gjendja e Pandemisë po vazhdon të jetë prezente dhe me rrezikshmëri të lartë. Unë propozoj që të bëhet një rekomandim, që të vazhdojë bashkëpunimi i ZKKK-së me ekipen e OJQ-ve, si dhe me Shtabin Emërgjent, për përkrahjen e familjeve nevojtare me pako ushqimore dhe higjenike, si dhe me kërkesa të tjera që kanë të bëjnë me përcjelljen e mësimit nga distanca të 151 nxënësve.

* Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -III- për vitin 2020, të mbajtur më: 13.05.2020, unanimisht i rekomandon, Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, si dhe Shtabit Komunal

Emergjent, që të vazhdojë me bashkëpunim të ngushtë mes Shtabit Emergjent, ZKKK-së dhe Ekipeve të OJQ-ve, për përkrahjen e familjeve nevojtare me pako ushqimore dhe higjenike, si dhe me kërkesa të tjera për 151 nxënës për përcjelljen e mësimit nga distanca, meqenëse gjendja e pandemisë të gripit me Korona-virus, i njohur si KOVID19 ende po vazhdon.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 14.55 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Rrahman Kadrija

